



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2009

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos lër asgjë pa lexuar!

Ngjite njëren shifër në vendin e caktuar të testit („Shifra e kandidatit“), kurse shifrën tjetër në vendin e caktuar në listën e përgjigjeve.

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo t'i zgjidhësh detyrat pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar fjalinë me përgjigjet e ofruara;
- duke shkruar tekst në vendin që është paraparë për atë;
- duke shkëputur pjesë (fjalë, grup fjalësh, fjali ose pasuse nga tekstet e dhëna) etj.

Gjatë dhënies së përgjigjeve duhet të kesh kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. **Shkruaj lexueshëm.** Përgjigjet që nuk lexohen, shkarravitjet ose të rrethuarit e më shumë varianteve vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj me stilolaps. Përgjigjet dhe detyrat e shkruara me laps, vlerësohen me zero pikë. **Pranë çdo pyetjeje dhe detyre janë dhënë pikat për përgjigjen e saktë.**

Rreptësisht ndalohet të kopjimi. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me (0) pikë.

Së pari zgjidhen detyrat në test. Pasi t'u përgjigjesh pyetjeve në test, përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve, sipas udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Të urojmë sukses!

FAQE E ZBRAZËT



1 Lexoje tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve!

TARTUFI (FRAGMENT AKTI IV SKENA VII)

Skena VII

Tartufi

Çdo gjë në rregull, Zonjë, sipas qejfit:
Pashë çdo qoshe të apartamentit
S'ka xhan njeri; nga lumturia zemra...
(kur Tartufi i afrohet Elmirës, kjo largohet dhe Tartufi e sheh Orgonin)

Orgoni

Ndal! Si shumë me nxitim e muart,
Mbajuni pak se mos pësoni gjë.
Ah! Shënjtërushi ynë, mënt më hodhët!
Ju qënki ç'qënki: unë ju jap çupën,
Dhe ju vini syno s'ime shoqeje!
S'pandeve kurrë të ish e vërtetë,
Dhe prisnja ças për çast ë të ndronit ton;
Çdo gjë është e qartë: s'duhet hiç më tepër.

Elmira

E bëra këtë lodër jo nga qejfi,
Po vetëm pse më shtrëngoi nevoja.

Tartufi

Çfarë ju pandehni...

Orgoni

Kyçeni, ju lutem,
Dhe ikni që këtej pa e zgjatur shumë.

Tartufi

Qëllimi im...

Orgoni

Këto s'ju pinë ujë,
Po hë, o burra! Dilni nga shtëpia.

Tartufi

Të dilni ju, jam i mallit unë!
Shtëpia është imja e do ta shihni.
Se s'pyes për kësi intrigash t'ulta
Që kundër meje dini të kurdisni.
Kush më bie në qafë është i çmendur
Di unë e kam se si t'ja rrëfej vendin,
Si ta ndëshkoj për çpifjet që kurdis
E për dhunën që i bën Qiellit vetë.

*(Fragment nga „Tartufi” - Moliere;
akti IV skena VII)*

(1.1) Çka zbulohet në këtë fragment?

1 pikë

1	2
---	---

(1.2) Pse Orgoni e përzë Tartufin?

1 pikë

1	2
---	---

(1.3) Ç'dëshmojnë fjalët e Elmirës?

1 pikë

1	2
---	---

(1.4) Cilit lloj të dramës i takon vepra „Tartufi”?

1 pikë

1	2
---	---

(1.5) Cilit drejtim letrar i takon vepra „Tartufi”?

1 pikë

1	2
---	---



2 Lexoje me vëmendje tekstin e mëposhtëm!

Në mbrëmje erdhi të më kërktojë Maria dhe më pyeti a dëshiroj të martohem me të. I thashë se kjo ishte krejt një për mua dhe se mund të martohemi në qoftë se ajo dëshiron këtë. Pastaj ajo desh të marrë vesh a e doja unë. Iu përgjigja pikërisht ashtu si i pata thënë edhe një herë tjetër më parë, se ajo s'kishte kurrfarë rëndësie, por që, pa fije dyshimi, nuk e doja. „Atëherë pse do të martoheshe me mua?“, tha ajo...

Atëherë ajo shtoi se martesë është një punë serioze. Unë iu përgjigja: „Jo“. Për një kohë ajo heshti dhe më shikonte pa folur gjë. Pastaj foli. Ajo donte vetëm të marrë vesh a do të pranoja unë për këtë propozim edhe sikur atë ta bënte një grua tjetër, në të cilën do të kisha pasur lidhje të njëjtë si me të. I thashë: „Natyrisht“. Atëherë ajo i bën vetvetes pyetjen a më donte, e sa për këtë anë, unë s'dija me të vërtetë asgjë. Pasi heshti një kohë të shkurtër, filloi të murmuronte, duke më thënë se unë qenkam njeri i çuditshëm, se pa fije dyshimi më donte vetëm për këtë arsye, ndoshta, një ditë prej ditësh pikërisht për këto shkaqe do t'i neveritem.

... Unë i thashë se mund të lidhim kurorë kur të dojë ajo.

(Fragment nga romani „I huaji“ A. Kamy)

(2.1) Në cilën vetë zhvillohet rrëfimi në fragmentin e mësipërm?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në vetën e parë njëjës.
- B. Në vetën e dytë shumës.
- C. Në vetën e tretë njëjës.

1 pikë

(2.2) Sipas fragmentit të dhënë, ç'dëshiron Maria?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Të ndahet.
- B. Të martohet.
- C. Të udhëtojë.

1 pikë

(2.3) Me cilën veti dominuese është karakterizuar personazhi kryesor në fragmentin e dhënë dhe në romanin në tërësi?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Me ndjeshmërinë.
- B. Me indiferencën.
- C. Me kureshtjen.

1 pikë

(2.4) Cilës periudhë të Historisë së Letërsisë Botërore i takon ky roman?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Romantizmit.
- B. Realizmit.
- C. Modernizmit.

1 pikë

(2.5) Filozofia të cilën e përfaqëson autori në këtë vepër bazohet në idenë

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. jeta e njeriut është absurde.
- B. rruga gjer te suksesi është e rëndë.
- C. martesë i zgjidh të gjitha problemet.

1 pikë

(2.6) Në cilën kohë është folja thashë në fjalinë e dytë të fragmentit?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në të pakryerën.
- B. Në të kryerën.
- C. Në të kryerën e thjeshtë.

1 pikë

3 Lexoje tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve!

Nuk e dini ju se sa kujdeseshin ato për mua kohët e para të martesës së tyre! (Oh! ç'martirizim mizor!) U dhashë të dyjave nga tetëqind mijë franga, s'kishin si të silleshin keq me mua, as ato, as burrat e tyre. Pa t'i shikojë si më prisnin. „Këtu babush, atje babaçko“. Gjithnjë shtruar do ta gjeja tryezën tek ato, me një fjalë haja bashkë me burrat e tyre që më nderonin shumë. U dukej se unë diç kisha akoma. Pse vallë unë skisha folur kurrë për tregtinë time, një njeri që u jep të bijave nga tetëqind mijë franga prikë, e vlen që të përkujdesesh për të. Dhe, ato më s'dinin ç'të bënin, po u bënin nderë parave të mia, jo mua. Ç'botë e qelbur! Ia kam pirë lëngun unë! Më shpinin në karrocë në teatër, dhe, kur më pëlqente, rrija në mbrëmjet që bënin. Shkurt, ato s'e kishin për turp që ishin për turp që ishin vajzat e mia. S'jam unë budalla, unë, jo, mos kini merak, të gjitha i kam vënë re. Gjithë plumbat kanë goditur në shenjë dhe më kanë përshkuar zemrën. E shihja fare mirë unë që ma kishin me djallëzi; po qe sëmundje që s'kishte ilaç. Në tryezën e tyre rrija si mbi gjemba, s'e ndieja mirë si në tryezën e pensionit. Unë s'dija të thosha dy fjalë bashkë dhe, kur i pyeste dhëndurët e mirë ndonjë nga ata zotërinjtë e shoqërisë së lartë: „Kush është ky zotëria?“ ata i përgjigjeshin: „Është babai i florinjve, është i pasur“. „Hej, djalli!“ – ia bënte ai dhe më vështronte me respektin që u bëhet florinjve. Po dhe në bezdiseshin ndonjëherë nga unë, ua shpërbleja dyfish me të mira atë bezdi. Fundja, kush është i përsosur? (Plagë e kam këtë të shkretë kokë!) Unë heq e vuaj tani gjithë sa mund të vuajë njeriu kur jep shpirt, o i dashur Eugjen, po të gjitha këto s'janë asgjë përpara dëshpërimit që më shkaktoi vështrimi i parë i Anastasisë, ai më dha të kuptoja se kisha thënë një marrëzi që e kisha fyer. Vështrimi i saj më futi në dhe të gjallë. Do të desha t'i mësoja të gjitha, por vetëm një gjë kuptova mira: që isha i tepërt në këtë botë.

(Fragment nga romani „Xha Gorio“ Honore de Balzak)

(3.1) Sipas fragmentit të dhënë, pse të bijat e duan dhe e respektojnë të atin?

1 pikë

1	2
---	---

(3.2) Çfarë shihte babai në sjelljen e këtillë të bijave?

1 pikë

1	2
---	---

(3.3) Sipas rrjedhës së ngjarjes në këtë vepër, kur e kupton personazhi kryesor qëndrimin e vërtetë të të bijave?

1 pikë

1	2
---	---

(3.4) Si janë paraqitur raportet familjare në këtë roman?

1 pikë

1	2
---	---

(3.5) Shkruaje emrin e tërësisë së veprave me të cilat Balzaku e paraqet shoqërinë franceze të shekullit XIX?

1 pikë

1	2
---	---

4 Lexoje tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve!

ERVEHEJA (Fragment)

Pa dëgjoni një **hiqajet** ¹⁾
në zemanëra të parë
Në Revza e bën **rivajet** ²⁾
punëra që kanë ngjarë.

- **hiqajet** = tregim

- **rivajet** = tregon

Në vaki Beni **Israil** ³⁾
Si ngjau pun' e Ervehesë,
Kush ish i urtë dhe **akil** ⁴⁾
prej hiqajetn të merr pjesë.

- **Beni israil** - të bijve të Israelit

- **akil** = i mençur

Erveheja qe një grua,
që s' kish shoqe nd'atë ditë:
vajzë dhe si u martua,
posi hëna që bën dritë

Bukurinë e kish mehshur
fort qe një konj e ndershurë;
burrën e kish bërë **mamur** ⁵⁾
edhe huje të bukurë.

- **mamur**= të lumtur

Burr' i saj e kish në **nazar** ⁶⁾
që s'e duaj vetëhenë,
as më tjetër bën karar
grua, veçse Ervehenë.

- **nazar** = në sy të mirë

Erdhi rasti që kish adet
burr' i saj do dil' në gurbet,
dërgon të vëllajt e i flet,
gruan t'i ler' amanet.

Ti vëlla, bënu mukajet
maksus për gruan time,
që t'i gjendeç në çdo hizmet,
të mos i lipset as qime;

se u'ja që vura tahmin
të vete n' udhë të gjatë,
dhe tek ti u bë **emin** ⁷⁾
që t'i gjendeç dit' e natë.

- **besova**

(4.1) Në strofën e gjashtë të fragmentit të dhënë autori flet për

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. skamjen.
- B. kurbetin.
- C. vëllavrasjen.

1 pikë

(4.2) Çfarë afirmon autori në këtë fragment të poemës?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Besnikërinë.
- B. Mençurinë.
- C. Religjionin.

1 pikë

(4.3) Vepra „Erveheja” e Muhamet Kyçykt-Çamit sipas formës dhe strukturës letrare është

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. roman.
- B. këngë lirike.
- C. poemë.

1 pikë

(4.4) Me çfarë alfabeti është shkruar kjo vepër?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Grek.
- B. Latin.
- C. Arabo-turk.

1 pikë

(4.5) Në vargun Bukurinë e kish mshenur fjala bukurinë është

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. përcaktor.
- B. rrethanor.
- C. kundrinë.

1 pikë

GJERDEKU I VASHËS

.....
Çupatë po rrinë syqyt
s'vështrojnë asnjëri në syt,
po thonë: „Vallë, kun a mbyt!
Vallë, ku kemi meqanë?”

.....
Çupatë po bëjnë fiqir;
„Vallë, ku e kemi takdir?”
I martojnë me të pahir,
Se ymër në dorë s'kanë.

.....
Djalit kur t'i vijnë nishan,
e merr, e nxjerr në mejdan,
zë valle; këng' e bën xhevelan
zë jorgan e tamburanë

.....
Si të zihet i ziu djalë,
në kurbet po rreh të dalë,
haj me këmbë, haj me kalë,
rreh të fitonjë paranë.

Çupa vë gjergjefn' e qëndis,
kryetë hiç nuke lëviz,
po me vetëhe murmuris:
„S' duhet as të rri pranë”.

Djali ven e ve terzitë,
i dërgon i sjellë evgjitë,
e bën aheng nat, e ditë,
gjersa të sosën vadanë

.....
Djali dhëndërë nisetë
Vesh robotë e stolisetë
Posi mashkulli ndizetë
Me krushq e me dambullhanë

Hasan Zyko Kamberi

(5.1) Çka përshkruan poeti në fragmentin e dhënë?

1 pikë

1	2
---	---

(5.2) Sipas fragmentit çka duhet të bëjë djali që të martohet?

1 pikë

1	2
---	---

(5.3) Çfarë vargu përdor poeti?

1 pikë

1	2
---	---

(5.4) Në cilën të folme është shkruar poezia?

1 pikë

1	2
---	---

(5.5) Foljen flas shkruaje në kohën e pakryer!

1 pikë

1	2
---	---

6 Lexoje fragmentin dhe përgjigju pyetjeve!

Koha, atë mëngjes, aty qante, aty qeshte.

Karvani dy qeresh të zbuarve posa kishte lënë pas mullirin e beut, kodrën e Shkozës dhe kishte hyrë në Fier.

.....

Në qerren e parë të karvanit, ngushtuar nga regullimat e shtëpisë, përveç Pilos që e ngiste, ishte e reja me të vjehrën. Plaka e ndenjtur te koka e nuses, te koka i thënçin, se gruaja që po çaplehej në të dhemburat e hidhura të lindjes (ku vinte koken, s'vinte këmbët). Kishte kryqosur duart në kraharor me një pikëllim të madh dhe s'dinte ç'të bënte. Vetëm kur ranë kambanat e Shën-Gjergjit, që lajmëronin se po dilte nga kisha, plakës iu kujtua zoti i madh dhe filloi t' i lutej shenjtit t' i lehtësonte dhimbjet së resë e t' i ipte lirim të mbarë. Me gjithë të keqtë e atij çasti, nuk harroi të falej që t' i gëzonte shtëpinë me një djalë.

.....

- Ashtu, vërtet, moj nënë, djalë qoftë, çupë mos u bëftë, se ne gratë na ka nëmur zoti qëkur na ka bërë gra...

.....

Gjunjët, mbledhur mbi bark, iu përpoqën në faqen e një dengu me plaçka. Rrangullat e shtëpisë u rrokullisën me dy qerre dhe një trastë shkau e ra në tokë. Trahanaja e imët dhe e thatë kërcëke u perhap mbi baltë.

- Uaha kazil, uaha kuqo! U foli Piloja qerreve që të ndalojnë dhe vetë, si pështeti hostenin në tokë, u hodh poshtë.

Edhe qerrija e dytë pushoi së qari. Qetë duke shfryrë jashtë avullin e dendur e të ngrohtë, zhytën turinj të në trahana dhe nisën të përtypen me qejf. Një shkumë e bardhë filloi t' u rrjedhë si zinxhir i hollë nga të dy anët e bulçive.

Nga bishti i qerres së pasme kërceu në rrugë dhe ndau drejt së parës një vajzë nja gjashtëmbëdhjetë vjeçe. I ra baltës përmes dhe doli në krye të karvanit. Ishte Vita, çupa e madhe e Pilos.

- Ç'kërkon, moj bijë, që erdhe!...I foli gjyshja.- Nuk bën të rish, këtu, po shko...Je çupë e rritur tashti...

- Nëna, ç'ka nëna?...

.....

Sytë e vajzës, si kaluan një çast vështrimin e plogët e të qullët të kafshës që vinte pas, u mbushën përnjëherë me lot. Bulzat e ujit mbi faqen e një pellgu të rrahur nga shiu, dukeshin si barka të vogla që kishin ngritur velat për udhëtim, ashtu si lotët e vajzës që kishin marrë te poshtë faqeve. Kapur fort pas hunjve të qerres, kokën pështetur mbi faqen e rrogosit që mbulonte plaçkat dhe binte gjer poshtë, vështrimin mbytur në atë re të madhe shiu, as Vita s' e kuptonte dot kush ja ndillte gjithë këtë trazim e pikëllim: arratia nga fshati ku kishte lerë e ishte rritur, lëngimi dhe dhimbjet e nënës, apo ndonjë duf i ri që s' e pati ndjerë gjer atë ditë në kufijt e fshatit të saj, në gjerdhet e kasolles së saj.

E ku kuptohet ndonjëherë nga çastisin rrëketë që mbushin lumin dhe e bëjnë të buçasin nga shtrati dhe udha e tij!...

(Fragment nga „*Lumi i vdekur*”- Jakov Xoxa)

(6.1) Shpërngulja e familjes së Pilo Shpiragut është rezultat i

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. dhunës nga bejlerët.
- B. dëshirës për një jetë më të mirë.
- C. marrëveshjes me tregtarët e Fierit.

1 pikë

(6.2) Ngjarjet e romanit „Lumi i vdekur” autori i vendos

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. në prag të Luftës së Dytë Botërore.
- B. gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- C. pas Luftës së Dytë Botërore.

1 pikë

(6.3) Në cilin vend është vendosur ngjarja e këtij fragmenti?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në Myzeqe.
- B. Në Fier.
- C. Në Shkodër.

1 pikë

(6.4) Cilin drejtim letrar i takon Jakov Xoxa?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Letërsisë së Rilindjes Kombëtare.
- B. Letërsisë bashkëkohore.
- C. Letërsisë së vjetër shqiptare.

1 pikë

7 Lexoje tekstin dhe përgjigju pyetjeve!

DASHURIA

.....
Kur jeshmë të vegji, si moll' e pa bërë
Putheshim nga herë ditënë të tërë;
Vij' e të kërkojë, vij' e të thërresë,
Losnim të dy bashkë, rronim me një shpresë.
Mba mënt sa të desha, mba mënt sa më deshe?
Mba mënt si më thoshe e vogël kur jeshe?
.....

Bukuria jote, leshërat e tua
Po si pënë korbi, të gjata mi thua
Ballëtë si diell, faqetë si mollë,
Qafa jot' e gjatë, mesi yt i hollë,
Buzët si burbuqe sytë si gështenjë.
.....

Kam dashur lulet, gonxhen, trëndafilë,
Zoqtë që këndojnë, thëllëzat, bilbilë;
Tani s'më pëlqejnë, më lënë të ftotë,
Se dua një çupë si hënëz e plotë
.....

Më mirenë mëntë, nga sytë **verbonem**
Dhe nga dashuria digjem, **përvëlohem**
Se digjem në zemër gjithë sa e **njonë**,
Maniten të tërë trimat kur e **shonë**,
Mashala! i **thonë**.

Andon Zako Çajupi

(7.1) Cilën figurë stilistike e përdor autori në vargjet e strofës së dytë në fragmentin e dhënë?

1 pikë

1	2
---	---

(7.2) Çfarë motivi kanë vargjet e dhëna?

1 pikë

1	2
---	---

(7.3) Çfarë rime ka në vargjet me shkronja të errësuarra dhe të nënvizuara?

1 pikë

1	2
---	---

(7.4) Cilës periudhë letrare i takon Çajupi?

1 pikë

1	2
---	---

(7.5) Shkruaj sinonimet e fjalës çupë!

1 pikë

1	2
---	---

8 Në fjalinë:

1 pikë

Shumica e shkrimtarëve tanë i shërbyen atdheut me penë e pushkë në dorë

emri **atdheut** është në rasën

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. kallëzore.
- B. gjjinore.
- C. dhanore.

9 Cila fjalë është shkruar gabimisht

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

1 pikë

- A. u rrëzua.
- B. u shëndrua.
- C. u lëndua.

10 Kryefjala **ky** në fjalinë e parë (kryesore)

Ky është viti i dytë që nxënësi shprëblehet

shprehet:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

1 pikë

- A. me mbiemër.
- B. me përemër dëftor.
- C. me përemër vetor.

11 Cila nga fjalitë e mëposhtme është fjali e thjeshtë?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

1 pikë

- A. Dëgjo ç'të thonë.
- B. Dëgjo mirë çdo këshillë të më të rriturve.
- C. Dëgjo shtatë a tetë, bëj si di vetë.

12 Në fjalinë:

1 pikë

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është një ngjarje e shënuar në historinë e kulturës sonë

funksionin sintaksor të kryefjalës e kryen togfjalëshi

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. një ngjarje e shënuar
- B. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe
- C. historinë e kulturës sonë

13 *Letra të zbuluara kohët e fundit të Njutonit zbuluan interesin sekret të alkimisë.*

1 pikë

Fjala e nënvizuar në morfologji është

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. mbiemër.
- B. folje.
- C. ndajfolje.

14 **Gabimisht është shkruar**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Universiteti shtetëror i Tetovës.
- B. Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- C. Akademia e Skencave e Shqipërisë.

1 pikë

15 **Lexojeni periudhën e mëposhtme, mandej rrethojeni përgjigjen e saktë!**

Vjosa hyri në dhomë, shkoi te dritarja, e ngriti perden dhe i hapi kanatet.

Periudha e mësipërme është e përbërë prej

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. dy fjalish.
- B. tri fjalish.
- C. katër fjalish.

1 pikë

16 **Mjekët i shërojnë sëmundjet, *mësuesit* gabimet.**

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza në këtë fjali e kryejnë funksionin sintaksor të

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. kundrinës.
- B. kryefjalës.
- C. përcaktorit.

1 pikë

17 **Sa rrokëshe është fjala *superlative*?**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Tërrokëshe
- B. Pesërrokëshe
- C. Gjashtërokëshe

1 pikë

RESTORANTET MË TË PAZAKONSHME NË BOTË

Kuzhinat kombëtare nuk janë më sfidë e restoranteve të kohës sonë ultramoderne. Në kërkimin e diçkaje të ndryshme, diçkaje të paparë dhe origjinale, karakteristikë kryesore u bënë meny-të e pazakonshme, por edhe konceptet e pazakonshme të gatimit. Bota gjithnjë e më pak do vetëm të hajë e gjithnjë e më shumë do të përjetojë e të njohë duke ngrënë. Në restorantet më të pazakonshme që ekzistojnë në rruzullin tokësor, darkën e shërbejnë ninxha, ju ofrohen kaproj të përgatitur në mënyrë të pazakonshme në pjata akulli, derisa ju rrini në errësirë ose, ndoshta, në tavolinë, që për shembull, rri pezull lart në ajër...

Vetë meny-të janë në shërbim të konceptit gjeneral, e kështu tre përcaktimet çka, ku dhe si hani bëhen krejtësisht të barabarta. Harrojini kafenetë e pahijshme të lagjes me ushqim të shkëlqyeshëm, restorantet luksoze me shije (mbi)mesatare...dhe filloni të ëndërroni për një qasje krejtësisht të re ndaj ushqimit, por edhe ndaj vetvetes, si një konsumator i tij.

„El Buli”

„El Buli” është më se një restorant, ai është një oazë e vërtetë e kuzhinës që 6 muaj ekziston në mes të shkretëtirës së përditshmërisë. 6 muajt e tjerë mbyllet në mënyrë që t’ju mungojë, që ta dëshironi vendin, të zakonshëm vetëm në shikim, kafene vetëm në shikim. „El Buli” është një Mekë e vërtetë gastronomike e haxhilerëve grykës e të gjitha meridianëve. Në të nuk ka ndonjë ushqim që shquhet në mënyrë të veçantë, sepse çdo gjë që shërbehet është kryevepër e artit të kuzhinës dhe eksponat i vërtetë për shqisat. Sipas jurisë së revistës prestigjioze Restorant, „El Buli” tre vjet me radhë është restoranti më i mirë në botë. Gjendet në qytezën Roses në bregun e Kosta Bravës në Spanjë dhe punon nga prilli gjer në shtator, kurse rezervimet bëhen një vit më parë. Gjatë një sezoni gjithsej ka 8000 vende, për të cilat paraqiten rreth gjysmë milion njerëz. Çdo natë, 50 gjellëbërës gatuajnë më së shumti për 50 mysafirë. Gjellëbërësi kryesor – Feran Adria Akosta (1962) pas përfundimit të sezonit, tërhiqet në atelienë e vet të kuzhinës / laboratorin në Barselonë ku prej fillimi e përpilon meny-në e plotë për vitin e ardhshëm. Darkat në këtë restorant zgjasin nga disa orë dhe përmbajnë tridhjetë ushqime. Racionet janë mjaft të vogla, por prandaj çdo racion është rrëfim më vete. Që përjetimi të jetë i plotë, duhet të ndiqen me kujdes rekomandimet e gjellëbërësve. Shërbehen kokteje në formë të kubit të borës, të fletëve të holla, në dukje si të letrës, të stërpikur me lule me ngjyra të forta dhe në fakt edhe ‘vezë’ çili, prej të cilave, pasi që t’i thyeni në gojë ju derdhet e verdha e ngrohtë si krem, me shije të kameles, kuti me kavijar ku ‘margaritarët’ shtrihen në kavijarin, por që kanë shije frutash...

Cilësia e ushqimeve që ofrohen në „El Buli” është e jashtëzakonshme. Pronarët thonë se gatimi është një gjuhë me të cilën kreativiteti, harmonia, gëzimi, bukuria, poezia, kompleksiteti, magjia, humori, provokimi dhe kultura shprehen më së miri. Të gjitha këto i ka çdo pjatë e vetme në „El Buli”.

(Klubi 360, nëntor 2008, nr. 63, O.Q.)

(20.1) Cila është karakteristika kryesore e restoranteve të kohës sonë ultramoderne?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Meny-të e pazakonshme.
- B. Arkitektura e pazakonshme.
- C. Muzika e pazakonshme.

1 pikë

(20.2) Çfarë duan njerëzit sot në restorantet e reja moderne?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Të lexojnë gazeta duke ngrënë.
- B. Të bëjnë biseda afariste duke ngrënë.
- C. Të përjetojnë e të njohin duke ngrënë.

1 pikë

(20.3) Çfarë racionesh shërbehen në restorantin „El Buli”?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Racione të zakonshme.
- B. Racione të vogla e kreative.
- C. Racione të varfra.

1 pikë

(20.4) Çka shprehet përmes ushqimit në restorantet siç është „El Buli”?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Vetitë e kuzhinës kombëtare.
- B. Kreativiteti, harmonia, gëzimi, bukuria, poezia, kompleksiteti, magjia, humori, provokimi dhe kultura.
- C. Raporti i hidrokarbureve, proteinave dhe yndyrave.

1 pikë

(20.5) Në fjalinë e parë, *Kuzhinat kombëtare nuk janë më sfidë e restoranteve të kohës sonë ultramoderne*, mbiemër është fjala

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. sfidë.
- B. ultramoderne.
- C. e restoranteve.

1 pikë

BIBLIOTEKAT MË TË NJOHURA NË BOTË

Bibliotekat janë banka të kujtesës së njerëzimit. Madje edhe kur s'ekzistojnë më, si ajo e Aleksandrisë, e themeluar në shekullin e tretë para erës sonë e që u dogj me 700 mijë pergamenat e papërsëritshëm. Por, në kohët tona, „banka” të tilla janë të shumta. Ajo më e madhe ndodhet në Tokën e Premtuar.

Biblioteka e Kongresit

Biblioteka e Kongresit është e regjistruar si biblioteka më e madhe në botë në librin „Gines”, bazuar në hapësirën që zë koleksioni me libra.

Ajo ndodhet në Uashington DC dhe në gjatësi lineare ka 850 kilometra rafte. Koleksioni i kalon 29 milionë libra dhe materiale të tjera të printuara në 470 gjuhë, më shumë se 58 milionë dorëshkrime, librat me të rrallë duke përfshirë edhe Biblën e Gutenbergut, 1 milion numra të gazetave të botës, 4, 8 milionë harta etj.

Biblioteka e Britanisë së Madhe

Biblioteka e Britanisë së Madhe ndodhet në Londër. Në bibliotekë janë shënuar përafërsisht 25 milionë libra. Në mars të vitit 2004 Biblioteka kishte 11, 2 milionë monografi. Si një bibliotekë depozituese, ajo merr kopjet e afërsisht të gjithë librave të prodhuar në Britani si dhe ato të prodhuar jashtë, po që ribotohen në vend. Ajo shton rreth 3 milionë botime në vit. Si institucion, biblioteka britanike është e re krahasuar me ato të vendeve të tjera.

Ajo është themeluar në vitin 1753, por para saj libraria kombëtare ka qenë pjesë e Muzeut Britanik.

Biblioteka Kombëtare e Kinës

Ajo ndodhet në Peking dhe është biblioteka e tretë më e madhe në botë dhe më e madhe në Azi. Ka një koleksion prej 22 milionë vëllimesh, ku përfshihen 1, 6 milionë libra antikë.

Paraardhësja e saj, biblioteka e kryeqytetit, u themelua më 24 prill të vitit 1909 nga Qeveria Qing. U hap për herë të parë zyrtarisht pas Revolucionit Xinhai në vitin 1912. Në vitin 1928, asaj iu ndryshua emri i Biblioteka Kombëtare e Kinës. Atë e vizitojnë afërsisht 6 mijë deri 7 mijë vizitorë për çdo ditë.

Biblioteka Kombëtare e Gjermanisë

Është bashkim i Bibliotekës Kombëtare të Gjermanisë Lindore, të themeluar në vitin 1912, me atë të Frankfurtit, themeluar në vitin 1947, e që më pas u quajt Biblioteka Kombëtare e Gjermanisë Perëndimore.

Ajo ka një koleksion prej 18, 8 milionë librash, e përveç tyre dhe 4 milionë botime të llojeve të tjera. E ndarë në disa godina, në Leipcig ndodhen rreth 13 milionë botime, në Frankfurt 7, 8 dhe në Berlin 1, 2 milionë botime. Në të tria këto ndërtesa, qendrat janë fokusuar në specifika të ndryshme.

(Lajm, 2008)

(21.1) Çfarë paraqesin bibliotekat për njerëzimin?

1 pikë

1	2
---	---

(21.2) Cila është biblioteka më e madhe në botë?

1 pikë

1	2
---	---

(21.3) Cili libër nga librat më të rrallë gjendet në Bibliotekën e Kongresit?

1 pikë

1	2
---	---

(21.4) Pjesë e kujt ka qenë më parë Biblioteka e Britanisë së Madhe?

1 pikë

1	2
---	---

(21.5) Në cilin qytet ndodhet Biblioteka Kombëtare e Kinës?

1 pikë

1	2
---	---

(21.6) Gjeje kryefjalën në fjalinë: *Në bibliotekë janë shënuar përafërsisht 25 milionë libra.*

1 pikë

1	2
---	---

VESET DHE FOBITË E NJERËZVE TË MËDHENJ

Të qenit njerëz të mëdhenj nuk i bën ata aspak të paprekshëm nga veset, frika, apo fobitë e ndryshme.

Abraham Linkoln

Presidenti i 16-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Abraham Linkoln është i njohur si një nga liderët më të mëdhenj të këtij vendi. Gjithashtu, ai është i njohur dhe për kapelën e tij të gjatë që s' e hiqte asnjëherë. Kjo kapelë është e njohur sepse ai e kishte zakon që aty të mban-te një sere gjërash si letra, fatura, vula, lapsa, etj.

Hans Kristijan Andersen

Një prej shkrimtarëve më të famshëm të përrallave për fëmijë e të rritur, Hans Kristian Andersen kishte një frikë të tmerrshme se mund ta deklaronte të vdekur dhe ta varrosnin të gjal-lë. Ai pothuajse gjithnjë mbante me vete në xhep një letër ku shkruante se kushdo që mund ta gjente pa ndjenja nuk duhet të supozonte se ai ishte i vdekur derisa të ekzaminohet detajisht nga mjekët.

Pjetri i Madh

Cari i Rusisë, Pjetri i Madh bënte pjesë në ata njerëz të mëdhenj e të famshëm që përpos madhështisë së tyre mbartnin dhe frika e vese krejtësisht të pakuptimta. Pjetri i Madh kishte një fobi, e cila i zgjati prej vitit 1689 deri në vitin 1725 dhe ajo kishte të bënte me urat. Cari i Rusisë kishte frikë të kalonte nga njëri cep i urës në tjetrin.

Karli II

Mbreti i Britanisë së Madhe, Karli II, i cili e udhëhoqi vendin në vitet 1660-1685 kishte një zakon mjaft të çuditshëm dhe interesant. Ai mblidhte pluhur nga mumjet e faraonëve të Egjiptit dhe e përhapte atë në lëkurën e tij. Duke bërë një gjë të tillë ai mendonte se mund të përfitonte „madhështi të lashtë” nga ato të faraonëve egjiptianë.

Enriko Karuso

Këngëtari i madh i operas Enrico Karuso, i cili vdiq në Napoli në moshën 48 vjeçare përveç se një tenor i pakrahasueshëm ishte dhe një supersticioz po me të njëjtat përmasa. Ai konsultohet me një astrolog sa here i duhej të bënte udhëtime përtej oqeanit. Përveç kësaj ai nuk nisej asnjëherë për udhëtim ditën e martë ose të premte sepse sipas supersticioneve këto ditë janë ters.

Rihard Vagner

Sa here që kompozitori gjerman Vagner, udhëhiqte orkestrën e muzikës së drejtuar nga Felix Mendelson, ai mbante veshur dorashka. Pas performances, Vagner i hiqte dorashkat dhe i për-plaste në tokë që të merreshin nga një pastrues. Kjo sjellje vinte si pasojë e faktit se Mendelsoni ishte hebre dhe Vagneri ishte anti-semit.

(Agjencia FLOART-PRESS)

(22.1) Çka mbante në kapelën e tij presidenti Abraham Linkoln?

1 pikë

1	2
---	---

(22.2) Prej se frikësohej Andersoni gjatë jetës së tij?

1 pikë

1	2
---	---

(22.3) Çfarë fobie kishte Pjetri i Madh?

1 pikë

1	2
---	---

(22.4) Çfarë zakoni kishte Karli i II-të – mbreti i Britanisë së Madhe?

1 pikë

1	2
---	---

(22.5) Çfarë qëndrimi kishte Vagneri ndaj hebrenjve?

1 pikë

1	2
---	---

(22.6) Shkruaj rrethanorët e kohës në fjalinë: *Përveç kësaj ai nuk nisej asnjëherë për udhëtim ditën e martë ose të premte sepse sipas supersticioneve këto ditë janë ters.*

1 pikë

1	2
---	---

RRËFIME NË PESË GJUHË PËR QYTETIN ME SHTATË PORTA

„Legjenda më e vjetër për Shkupin thotë se pikërisht në këtë vend paska pasur një shkëmb, i cili paska qenë shumë i fortë dhe i mbyllur nga të gjitha anët. Ndonjë hero mitik e paska shpuar. Dhe paska bërë shtatë hyrje. Këtu paska zënë fill Shkupi.”, thotë profesor Ferit Muhiqi, i cili është autor i monografisë për kryeqytetin e shtetit tonë. Monografia ka dy vëllime dhe është paraparë të botohet në pesë gjuhë.

Tanimë janë botuar monografitë në gjuhën maqedonase dhe në atë angleze, në 5000 kopje, kurse promovimi i tyre do të bëhet në fund të gushtit. Ekipi që bashkë me Muhiqin e përgatitën këtë libër, i cili siç thotë autori: „është një përpjekje të jepet diçka më shumë se vetëm informatë për Shkupin”, përbëhet prej fotografit Rumen Qamillov dhe disejnerit të librit Vlladimir Borojeviq. Librin e boton qyteti i Shkupit, kurse botimin e kanë ndihmuar edhe disa fondacione të huaja joqeveritare, ndër të cilat më shumë mjete ka dhënë një organizatë joqeveritare nga Toskana.

„Bëhet fjalë për dy libra me nga 64 faqe. I pari mban titullin „Shkupi - qyteti me shtatë porta“, kurse i dyti titullohet „Shkupi - qyteti për t’u zbuluar“. Derisa në të parin gjendet parathënia për Shkupin, si dhe të gjitha të dhënat për ata që synojnë Shkupin, në librin e dytë gjendet rrëfimi për Shkupin, legjendat, historiku, monumentet, jeta e tij. Ai është qyteti, në të cilin vini me Shën Paulin, kurse largoheni me Lekën e Madh, është teza e librit. Kurse ideja ose legjenda për shtatë portat do të jetë ajo, të cilën prej tani do të përpiqemi ta instalojmë si ide themelore për qytetin. Ashtu si Nju Jorku që njihet si Molla e Madhe, Parizi si qyteti i dritave, Roma, qyteti i përjetshëm ose qyteti i shtatë brigeve, Shkupi do të jetë qyteti i shtatë portave” thotë Muhiqi.

Dy librat e monografisë jepen bashkë me kartën e re të Shkupit dhe rrethinës.

Ferit Muhiqi njëherit është autor edhe i monografisë për Maqedoninë, botuar nga „Taberna-kull”, të cilën e titulloi „Maqedonia – kopsa e botës”.

„Vest” - 17.08.2006

(23.1) Teksti i dhënë është shkruar në stilin

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. letrar-artistik.
- B. publicistik.
- C. administrativ.

1 pikë

(23.2) Autor i librit „Shkupi - qyteti me shtatë porta” është

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Vlladimir Borojeviqi.
- B. Rumen Qamillovi.
- C. Ferid Muhiqi.

1 pikë

(23.3) Prej sa librave përbëhet monografia për qytetin e Shkupit?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Prej dy librave.
- B. Prej tre librave.
- C. Prej katër librave.

1 pikë

(23.4) Me se njëmendësohen shtatë hyrjet dhe shtatë daljet e Shkupit?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Me zemrën e njeriut.
- B. Me trupin e njeriut.
- C. Me kokën e njeriut.

1 pikë

(23.5) Libri „Shkupi - qyteti për t’u zbuluar” është shkruar sipas

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. një ngjarjeje të vërtetë.
- B. legjende.
- C. kërkimi shkencor.

1 pikë

(23.6) Qyteti i Shkupit është i njohur si qytet

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. i shtatë portave.
- B. i shtatë brigjeve.
- C. i shtatë kodrave.

1 pikë

SA E RRALLË ËSHTË BOTA E GJALLË

Deri para 30 viteve vëllimi i kushteve që janë llogaritur të domosdoshme për jetë, për shembull temperatura dhe lagështia, ka qenë shumë i ngushtë. Ndërkohë, shkencëtarët i kanë zbuluar ekstremofilet dhe organizma, të cilat mbijetojnë në kushte ekstreme dhe të cilat jetojnë në mjediset më të papërshtatshme të Botës. Ato mbijetojnë thellë në brenditë e pllakave të akullit ose në ujin e vluar rreth çarjeve në fundin e oqeaneve. Disa prej tyre jetojnë në bashkësi. Deri tek ato nuk arrin drita e diellit dhe ato përdorin energjinë e burimeve kimike. Ekstremofilet janë dëshmi se bota e gjallë krijohet në vëllim të gjerë kushtesh. Disa shkencëtarë akoma shpresojnë se do të gjejnë forma jete në Sistemin Diellor jashtë Tokës, edhe pse studimet në planetin më të përshtatshëm për këtë, Marsin, deri më tani kanë dhënë rezultate negative.

Shumë shkencëtarë besojnë se ekzistojnë krijesa të gjalla jashtë Sistemit Diellor. Shkencëtarët më shumë interesohen a ekzistojnë në largësi aq të mëdha forma inteligjente të jetës, me të cilat mund të vendosen lidhje. Në vitet e gjashtëdhjeta të shek. 20, radioastronomi amerikan Frenk Drejk (i lindur më v. 1930) e formuloi barazimin, me të cilin parashikohet numri i civilizimeve në Galaktikë, të cilat kanë aftësi për komunikim ndërmjet yjeve. Meqenëse vlera e pothuaj asnjë faktori të barazimit nuk mund të përcaktohet me saktësi, rezultatet mund të kenë vlerën e më pak se një gjer në disa milionë, varësisht prej vlerësimit të vlerës së faktorit. Sidoqoftë, është e arsyeshme të parashikohet se në Rrugën e Qumështit do të kishte mundur të ekzistojnë të paktën disa civilizime të tilla.

(„Gjithësia” Mlladinska kniga,
Shkup 2008, f.53)

(24.1) Në çfarë mjedisesh jetojnë ekstremofilet?

1 pikë

1	2
---	---

(24.2) Si mbijetojnë organizmat e Tokës, te të cilat nuk depërton energjia e Diellit?

1 pikë

1	2
---	---

(24.3) Në çfarë kushtesh krijohet bota e gjallë?

1 pikë

1	2
---	---

(24.4) Cili planet është më i përshtatshëm për jetë në Sistemin Diellor?

1 pikë

1	2
---	---

(24.5) Sa është vlera e rezultateve të fituara nga barazimi i Frenk Drejkut?

1 pikë

1	2
---	---

(24.6) Cili rrethanor i kohës është përdorur në fjalinë e dytë në tekstin e dhënë: *Ndërkohë, shkencëtarët i kanë zbuluar ekstremofilet dhe organizma, të cilat mbijetojnë në kushte ekstreme dhe të cilat jetojnë në mjediset më të papërshtatshme të Botës?*

1 pikë

1	2
---	---

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT